



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
E-Turizëm B

Ngarkesa: 4 Kredite, 40 orë, 20 leksione/20 seminare

Viti / Semestri: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në "Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik Trigjuhësh

Kodi i etikës: Kodi i etikës së UT-së (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndor:

Të pajisë studentët me njohuri bazë dhe të thelluara për rolin e teknologjisë në industrinë e turizmit. Të zhvillojë aftësitë praktike të studentëve në përdorimin e mjeteve teknologjike për kërkimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit. Të aftësojë studentët për të komunikuar dhe bashkëpunuar në mënyrë efektive në mjedise dixhitale dhe ndërvepruese.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë terminologjinë kryesore të teknologjisë së informacionit të aplikuar në e-turizëm.
2. Të përdorë programe dhe aplikacione konkrete (si Google Sites, blogs, Google Classroom, VR/AR, etj.) për qëllime profesionale dhe prezantuese në fushën e turizmit.
3. Të marrë pjesë në mënyrë aktive në forume dhe platforma online duke demonstruar bashkëpunim dhe komunikim të qartë me pedagogë dhe kolegë.

Rezultatet e pritshme:

Studenti është në gjendje të kërkojë dhe të për zgjedhë informacion autentik nga interneti për ndërtimin e një guide turistike.

Studenti është në gjendje të përdorë mjete teknologjike për të krijuar dhe shpërndarë përmbajtje (si blogje, faqe web, materiale prezantuese, etj.).

Studenti komunikon në mënyrë efektive në platforma dixhitale, jep dhe merr feedback në mënyrë bashkëpunuese dhe kontribuon në mjedise të hapura online.